



232  
14.02.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE/MODULEVE TË TRAJNIMIT

Nr. 77 prot.

Tiranë, më 20 . 01 . 2022

VENDIM

NR. 69 / datë 20.01.2022

PËR PRANIMIN E APLIKIMIT DHE PËR VIJIMIN NË FAZËN E DYTË TË  
VLERËSIMIT ME MODULE TË REDUKTUARA

Në mbështetje të nenit 58 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 17 të udhëzimit nr. 16, datë 28.07.2021 të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë", të urdhrin nr. 461, datë 23.11.2021, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për ngritjen e Komisionit të Akreditimit të Programeve të Trajnimit", Komisioni i Akreditimit të Programeve/ Moduleve të Trajnimit pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë, lidhur me aplikimin për akreditimin e programeve/moduleve të trajnimit,

VENDOSI:

Pranimin e aplikimit dhe vijimin në fazën e dytë të vlerësimit të programeve/moduleve të trajnimit për agjencinë e trajnimit "UNIVERSITETI I KORÇËS "FAN S NOLI" QENDRA E FORMIMIT TE VAZHDUAR".

1. Agjencia të depozitojnë 3 (tre) kopje të formatit të plotësuar të aplikimit për temat e moduleve si më poshtë pa asnjë shenjë dalluese të agjencisë, sipas shtojcës 4, brenda afatit kohore 10 ditë kalendarike nga data e dërgimit të vendimit.
2. Lista e moduleve bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi, sekretariati i Komisionit të Akreditimit të Programeve/ Moduleve të Trajnimit, si dhe agjencia trajnuese e sipërpërmendur.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë*

KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE / MODULEVE TË TRAJNIMIT

Znj. Zamira Gjini

Kryetar

Znj. Dorina Rapti

Anëtar

Z. Alqi Kushi

Anëtar

Znj. Albana Çelaj

Anëtar

Z. Erzen Tola

Anëtar

Znj. Ines Todhe

Anëtar

Z. Gerti Janaqi

Anëtar



## UNIVERSITETI I KORÇËS "FAN S NOLI" QENDRA E FORMIMIT TE VAZHDUAR

1. Koncepte bazë mbi kurrikulën dhe të kuptuarit e saj.
2. Llojet e vështirësive në të nxënë. Strategji dhe praktika menaxhuese
3. Roli i psikologut dhe punonjësit social në shkollë
4. Modele praktike për studimin e teksteve letrare dhe joletrare. Eseja
5. Praktika me në qendër fëmijën dhe familjen. Perspektiva aktuale të partneritetit që ndihmojnë në mbarëvajtjen e programit në arsimin parashkollor.
6. Menaxhimi i programit parashkollor. Rolet dhe përgjegjësitë që kontribuojnë në cilësinë e tij.
7. Elementët të rinj kurrikularë të edukimit fizik në shkollë.
8. Përdorimi I mjeteve digjitale në mësimdhënie dhe të nxënë te grupmoshat e reja.
9. Qytetaria dhe identiteti kombëtar në kuadrin e diversitetit kulturor në shoqërinë globale.
10. Mësimdhënia për të menduarit kritik e krijues.
11. Kujdesi ndaj nxënësit dhe orientimi për karrierën.
12. Mentorimi dhe sfidat në zhvillimin e praktikave profesionale të mësuesisë.
13. Edukimi I të drejtave të njeriut.

